

MARRËVESHJE E SHITBLERJES SË AKSIONEVE

Kjo Marrëveshje e Shitblerjes së Aksioneve (në vijim "Marrëveshja") u lidh më datë 12.05.2026 në Tiranë, ndërmjet:

- **KAYO sh.a.**, shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjit nr. 88/2024 "Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake", e zotëruar 100% nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: M42216020F, me seli në Rrugën e Dibrës, Garnizoni Skënderbej, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar për nënshkrimin nga administratori Z. Ardi Veliu, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim "Shitësi" ose "KAYO");

dhe

- **MSSC GROUP sh.p.k.**, themeluar si person juridik shqiptar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: L01306040L, me seli në Rrugën "Dervish Hima", 3 Kullat, Kulla Nr. 1, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar për nënshkrimin nga administratori Z. Robert Gode, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim "Blerësi" ose "MSSC").

Shitësi dhe Blerësi referuar individualisht si "Pala" dhe së bashku si "Palët".

MEQENËSE:

- "GUNA TACTICAL" sh.a., është një shoqëri aksionare e krijuar nga Palët, regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me NUIS M52008021O, (këtu e në vijim "Shoqëria");
- Shitësi zotëron 51% të kapitalit aksionar të Shoqërisë, ndërsa Blerësi zotëron 49% të po atij kapitali;
- Blerësi ka paraqitur një angazhim të shtuar financiar dhe operacional për të realizuar, për llogari të Shoqërisë dhe Shitësit, një investim të konsiderueshëm në ndërtimin, instalimin dhe funksionalizimin e linjave të reja prodhuese, të domosdoshme për prodhimin e pajisjeve të specializuara të kërkuara nga strukturat ushtarake dhe të sigurisë;
- Ky investim, i cili tejkalon angazhimet fillestare të parashikuara në Planin e parë të Biznesit, përfshin ndërtimin e ambienteve industriale të reja, instalimin e teknologjive të avancuara dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme, dhe do të realizohet në prona që mbeten në përdorim dhe kontroll të shtetit shqiptar, përmes Shitësit, duke përbërë kështu një kontribut real për pasurinë publike pa asnjë shpenzim nga ana e shtetit;
- Këto investime, ndonëse financohen dhe realizohen nga Blerësi, do të mbeten të integruara në pasuritë dhe zhvillimet mbi truallin e vënë në dispozicion nga shteti shqiptar përmes Shitësit, duke i siguruar kështu shtetit pasuri të qëndrueshme pa asnjë shpenzim buxhetor;
- Si rrjedhojë e këtij angazhimi të shtuar, dhe në përputhje me parimet e shpërblimit proporcional të kontributit të Blerësit, Palët kanë rënë dakord që të kryhet transferimi i një pjese të kufizuar të aksioneve nga Shitësi te Blerësi, në mënyrë që të pasqyrohet në mënyrë të drejtë pjesëmarrja reale investuese në Shoqëri, pa cenuar kontrollin publik, të drejtat e veçanta dhe rolin strategjik të Shitësit;

A

[Signature]

- Palët kanë rënë dakord për shitblerjen e aksioneve që përfaqësojnë 2% të kapitalit aksionar të Shoqërisë nga Shitësi te Blerësi, në mënyrë që pjesëmarrja e Blerësit në Shoqëri të rritet nga 49% në 51%;
- Palët kanë rënë dakord që çmimi i transferimit të aksioneve të jetë i barabartë me vlerën e tregut të tyre, e cila do të përcaktohet sipas mënyrës dhe procedurës së parashikuar në Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;
- Njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të lidhin një Marrëveshje Aksionarësh të ndryshuar ("Marrëveshja Aksionare") si dhe Statutin e ri të përditësuar.

Prandaj, Palët bien dakord si vijon:

Neni 1 – Objekti i Marrëveshjes

1.1 Shitësi pranon të shesë dhe transferojë tek Blerësi, dhe Blerësi pranon të blejë nga Shitësi, 70 (shtatëdhjetë) aksione të zakonshme të Shoqërisë, që përfaqësojnë 2% (dy përqind) të kapitalit aksionar të Shoqërisë (në vijim "**Aksionet**"), të lira nga çdo barrë, peng, kolateral, kufizim apo pretendim i palës së tretë.

1.2 Ky transferim aksionesh përbën pjesë të një transaksioni më të gjerë ndërmjet Palëve dhe ka për qëllim të pasqyrojë kontributin e shtuar dhe angazhimet e zgjeruara të Blerësit sikurse përshkruhen në recitalët e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2 – Çmimi dhe Mënyra e Pagesës

2.1 Përcaktimi i Çmimit. Palët bien dakord që çmimi i shitblerjes së Aksioneve (në vijim "**Çmimi**") të jetë i barabartë me vlerën e tregut të Aksioneve, sikurse përcaktohet nga një ekspert vlerësues i pavarur, i licencuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë (në vijim "**Eksperti Vlerësues**"), i emëruar sipas Nenit 2.2 më poshtë.

2.2 Emërimi i Ekspertit Vlerësues.

(a) Eksperti Vlerësues do të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët mes Palëve me propozim paraprak nga KAYO.

(b) Eksperti Vlerësues do të përgatisë një raport të arsyetuar vlerësimi, në përputhje me standardet kombëtare të vlerësimit të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë

(c) Tarifat dhe shpenzimet e Ekspertit Vlerësues për kryerjen e vlerësimit do të përballohen në mënyrë të barabartë nga të dy Palët, sipas marrëveshjes së tyre

2.3 Metodologjia dhe afati i raportit të vlerësimit.

(a) Eksperti Vlerësues do të përgatisë një raport të arsyetuar vlerësimi, në përputhje me standardet kombëtare të vlerësimit, që përcaktojnë vlerën e tregut të Aksioneve në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur palët bien dakord ndryshe. Për qëllime të këtij vlerësimi Eksperti do të zbatojë metodologjitë e duhura për vlerësimin e ndërmartjeve,

A

përfshirë por pa u kufizuar në metodën e flukseve të skontuara të parave, metodën e transaksioneve të krahasueshme, ose transaksione të ngjashme (multiples), ose metodën e vlerës neto të aktiveve, duke ushtruar gjykimin e tij profesional për përzgjedhjen dhe peshëzimin e tyre.

(b) Raporti i vlerësimit duhet të dorëzohet te Palët brenda 3 (tre) muajve nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Para finalizimit të raportit, Eksperti Vlerësues duhet t'u sigurojë Palëve një draft për koment, me një afat prej të paktën 10 (dhjetë) ditësh për paraqitjen e komenteve me shkrim.

(c) Raporti përfundimtar i Ekspertit Vlerësues do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët, përveç në rast gabimi material të dukshëm ose shkeljeve të rënda të standardëve profesionale.

2.4 Pagesa e Çmimit

Pas dorëzimit të raportit përfundimtar të Ekspertit Vlerësues sipas Nenit 2.3, Çmimi do të paguhet, sipas zgjedhjes së Blerësit, përmes njëres prej alternativave të mëposhtme:

(i) **Pagesë e drejtpërdrejtë në para.** Pagesa e Çmimit nga Blerësi te Shitësi, përmes transfertës bankare në llogarinë e treguar nga Shitësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i raportit përfundimtar të Ekspertit Vlerësues; ose

(ii) **Ulje e detyrimit ekzistues nga Marrëveshja Aksionare.** Ulje e shumës totale të detyrimeve të rikuperueshme nga Blerësi (dhe rrjedhimisht e detyrimit korrespondues të Shitësit) sipas Marrëveshjes Aksionare, që lidhet me rikuperimin e investimit të MSSC-së për ndërtimin dhe zhvillimin e ambienteve të Shoqërisë, me një shumë të barabartë me Çmimin. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar të Ekspertit Vlerësues, shuma totale e rikuperueshme nga MSSC GROUP sipas Marrëveshjes Aksionare do të zvogëlohet proporcionalisht me një shumë të barabartë me Çmimin, pa qenë e nevojshme asnjë veprim tjetër formal nga ndonjëra prej Palëve.

2.5 Struktura e re aksionare.

Pas Mbylljes së parashikuar në Nenin 4, struktura e zotërimit të aksioneve të Shoqërisë do të jetë si vijon:

- — MSSC GROUP do të zotërojë 1,785 (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) aksione, që përfaqësojnë 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit aksionar të Shoqërisë;
- — KAYO do të zotërojë 1,715 (një mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) aksione, që përfaqësojnë 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit aksionar të Shoqërisë.

2.6 Palët konfirmojnë se kapitali i regjistruar i Shoqërisë mbetet i pandryshuar në vlerën 3,500,000 Lekë, i ndarë në 3,500 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë secili. Ndryshimi i vetëm si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje është rishpërndarja e zotërimit të aksioneve sikurse përshkruhet në Nenin 2.5.

A

Neni 3 – Trajtimi i dividendëve për periudhën para Mbylljes

3.1 Palët bien dakord se, pavarësisht ndryshimit të strukturës aksionare që ndodh me Mbylljen, të drejtat ekonomike mbi fitimet e realizuara nga Shoqëria deri në datën e Mbylljes (në vijim "**Data e Ndarjes**") i përkasin Palëve sipas strukturës së mëparshme aksionare 51% KAYO / 49% MSSC. Të drejtat ekonomike mbi fitimet e realizuara pas Datës së Ndarjes i përkasin Palëve sipas strukturës së re aksionare 49% KAYO / 51% MSSC.

3.2 Palët bien dakord që parimi i Nenit 3.1 do të zbatohet përmes një vendimi të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë, i cili do të miratohet në mbledhjen e parë të Asamblesë në të cilën shqyrtohet shpërndarja e dividendëve nga fitimet që përfshijnë periudhën deri në Datën e Ndarjes (në vijim "**Vendimi i Alokimit**").

3.3 Vendimi i Alokimit do të parashikojë, ndër të tjera:

- (a) ndarjen e fitimeve të shpërndarshme në dy pjesë, përkatësisht: (i) pjesën që i atribuohet periudhës deri në Datën e Ndarjes (në vijim "**Pjesa para Ndarjes**"), dhe (ii) pjesën që i atribuohet periudhës pas Datës së Ndarjes (në vijim "**Pjesa pas Ndarjes**"), të llogaritura mbi bazën e pasqyrave financiare të Shoqërisë dhe duke aplikuar kriterin e alokimit pro rata temporis;
- (b) shpërndarjen e Pjesës para Ndarjes ndërmjet KAYO-s dhe MSSC-së në raportin 51%/49%, përkatësisht;
- (c) shpërndarjen e Pjesës pas Ndarjes ndërmjet KAYO-s dhe MSSC-së në raportin 49%/51%, përkatësisht;
- (d) afatet dhe mënyrën e pagesës së dividendëve përkatës.

3.4 MSSC GROUP angazhohet të votojë në Asamblenë e Aksionarëve në favor të miratimit të Vendimit të Alokimit sikurse përshkruhet në Nenet 3.2 dhe 3.3 më sipër, dhe të mos ndërmarrë asnjë veprim që pengon, vonon apo cenon miratimin ose zbatimin e tij..

3.5 Zbatimi i këtij Neni 3 do të respektojë kufizimet e ligjit nr. 9901/2008, përfshirë kërkesat për mbrojtjen e kapitalit dhe rezervave të detyrueshme, si dhe çdo detyrim tjetër ligjor apo kontraktor të Shoqërisë.

3.6 Asnjë dispozitë e këtij Neni 3 nuk krijon detyrim personal të drejtpërdrejtë të MSSC GROUP për të paguar ndonjë shumë në favor të KAYO-s. Angazhimi i MSSC GROUP sipas Nenit 3.4 është një angazhim votimi dhe jo një detyrim pagese.

3.7 Pjesa para Ndarjes dhe Pjesa pas Ndarjes që i shpërndahen KAYO-s sipas këtij Neni i nënshtrohen mekanizmave që rregullojnë trajtimin e dividendëve dhe rikuperimin e investimeve sipas Marrëveshjes Aksionare. Çdo pjesë e Çmimit të mbuluar përmes këtyre mekanizmave do të reflektohet në uljen përkatëse të detyrimeve sipas Nenit 2.4 të kësaj Marrëveshjeje.

A

3.8 Pas miratimit dhe zbatimit të plotë të Vendimit të Alokimit, çdo shpërndarje e mëtejshme e dividendëve nga Shoqëria do të rregullohet ekskluzivisht nga struktura e re aksionare 49% KAYO / 51% MSSC GROUP dhe nga mekanizmat e Marrëveshjes Aksionare.

Neni 4 – Transferimi i Aksioneve dhe Mbyllja

4.1 Mbyllja e menjëhershme. Palët konfirmojnë se transferimi i pronësisë mbi Aksionet (në vijim "Mbyllja") ndodh në mënyrë të menjëhershme me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje nga të dyja Palët, pavarësisht nga përgatitja e mëvonshme e raportit të Ekspertit Vlerësues sipas Nenit 2.3, pavarësisht nga shtrirja në kohë e mekanizmit të uljes së detyrimit sipas Nenit 2.4, dhe pavarësisht nga koha e miratimit dhe zbatimit të Vendimit të Alokimit sipas Nenit 3.

4.2 Me efekt nga momenti i Mbylljes, MSSC GROUP bëhet pronar i ligjshëm i Aksioneve dhe gëzon të gjitha të drejtat dhe përfitimet që rrjedhin prej tyre, duke përfshirë pa u kufizuar të drejtën e votës në asamblетë e aksionarëve, të drejtën për dividendë dhe shpërndarje të tjera që mund të deklarohen pas datës së Mbylljes si dhe të gjitha të drejtat e tjera tregtare.

Neni 5 – Regjistrimi në QKB

Palët angazhohen që pas Mbylljes të ndërmarrin së bashku të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të Aksioneve pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB") brenda afateve ligjore të zbatueshme. Në veçanti, Palët do të bashkëpunojnë me Shoqërinë për depozitimin e dokumentacionit përkatës në QKB, me qëllim pasqyrimin e gjendjes së re të aksionarëve të Shoqërisë pas transferimit të Aksioneve, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 6 – Deklaratat dhe Garancitë e Shitësit

Shitësi deklaron dhe garanton para Blerësit si më poshtë:

- — Shitësi është pronari i ligjshëm dhe i pakufizuar i Aksioneve, duke pasur të drejtë të plotë dhe autoritet për t'i shitur e transferuar ato te Blerësi, pa pasur nevojë për pëlqimin ose miratimin e ndonjë palë të tretë.
- — Aksionet janë të lira nga çdo barrë, peng, kolateral apo kufizim tjetër; ndaj Aksioneve nuk ekziston asnjë e drejtë apo pretendim i paautorizuar nga ndonjë palë e tretë.

Neni 7 – Konfidencialiteti

Palët bien dakord që kjo Marrëveshje dhe çdo informacion i marrë në kuadër të saj do të trajtohen si konfidenciale. Asnjë Palë nuk do të zbulojë përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë informacion në lidhje me të tek asnjë palë e tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër. Përfshirë, secila Palë mund t'i zbulojë këto informacione nëse një gjë e tillë kërkohet nga ligji ose nga një autoritet kompetent (përfshirë regjistrimin e nevojshëm pranë QKB-së sipas Nenit 5), ose ndaj këshilltarëve të vet ligjorë a financiarë, me kusht që edhe këta këshilltarë të kenë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit.

Neni 8 – Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni



Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo Marrëveshje apo lidhet me të, e pamundur të zgjidhet me mirëkuptim, do t'i nënshtrohet dhe zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 9 – Dispozita Përfundimtare

9.1 Kjo Marrëveshje, së bashku me Anekset bashkëlidhur saj (nëse ka), përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve lidhur me objektin përkatës. Çdo ndryshim apo shtesë në këtë Marrëveshje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

9.2 Kjo Marrëveshje do të interpretohet në përputhje dhe në harmoni me Marrëveshjen Aksionare të palëve. Në rast mospërputhjeje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes Aksionare, kjo e fundit do të ketë përparësi. 9.3 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje shpallet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga ndonjë autoritet gjyqësor apo tjetër kompetent, dispozitat e tjera do të mbeten në fuqi dhe nuk do të preken. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një dispozitë tjetër të vlefshme që realizon sa më afër qëllimin ekonomik të Palëve. E njëjta vlen nëse zbulohen boshllëqe të paqëllimshme.

9.4 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pazbatueshme për shkak se nuk është e përfshirë në statutin e Shoqërisë, Palët angazhohen të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore apo statutores për të përfshirë dispozitën përkatëse në statutin e Shoqërisë.

9.5 Mospërdorimi ose vonesa në ushtrimin e ndonjë të drejte sipas kësaj Marrëveshjeje nuk përbën heqje dorë nga ajo e drejtë apo nga ndonjë tjetër. Heqja dorë nga ndonjë e drejtë apo mjet juridik nuk do të përbëjë heqje dorë të vazhdueshme dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë nga të drejtat apo mjetet e tjera që rrjedhin nga kjo Marrëveshje apo nga ligji.

9.6 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga të dyja Palët, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore, nga të cilat secila Palë mban nga një kopje.

Për "KAYO" sh.a.

Z. Ard VELIU



Për "MSSC GROUP" sh.p.k.

Z. Robert GODE

